



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**  
**REPUBLIC OF KOSOVA**  
**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/**  
**MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE**

Dt.02.08.2023

Nr. 256123

Në mbështetje të nenit 8, paragrafit 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010), nenit 5, pika c) të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, neni 67 të ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtaret Publik, nenit 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Drejtoria e Arsimit shpallë:

**K O N K U R S**

Për plotësimin e vendeve të punës

| Nr. | Niveli                          | Pozita                               | Vend i<br>Lirë/Zëvendësim        | Numri i<br>Pozitave |
|-----|---------------------------------|--------------------------------------|----------------------------------|---------------------|
| 1   | SHML "Hoxhë<br>Kadri Prishtina" | Mësimdhënës/e për lëndë<br>Ekonomike | Vend i lirë<br>nga dt.16.11.2023 | 1                   |

**I. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:**

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në Komunë, në Arkiv ose në web. të Komunës),
- Rezumeja personale (CV),
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë),
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara te Noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj. Çdo certifikatë e diplomës më e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit nuk do të merret parasysh,
- Certifikata që nuk jeni nën hetim,
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

**II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor:**

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar, Ligjit Nr.02/L-52, Ligjit Nr.03/L-068 dhe Ligjit Nr.04/L-138, si dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHT-it (UA Nr.05/2021) Udhëzimit administrativ (05/2015) dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik dhe sipas Udhëzimit administrativ (MASHTI) NR.06/2021 dhe 05/2021 normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional.

**-Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Lëndë Ekonomike:**

- Ekonomi dhe ndërmarrësi
- Marketing
- Praktike Profesionale

- Msc. i ekonomisë –profilit përkatës
- Ekonomist i diplomuar , banka financa dhe kontabilitet
- Ekonomist i diplomuar- përgjithshëm .
- Msc.Ekonomiks,marrëdhënie ndërkombëtare, ekonomike dhe diplomaci;
- Ekonomist i përgjithshëm.

**- Detyrat dhe përgjegjësitë :**

1. I punësuari është i obliguar të realizojë detyrat e punës si ne vijim:

- 1.1. Të realizoj planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/saj/të punës.
- 1.2.Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- 1.3.Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- 1.4.Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi, barazi dhe pa dallime me bashkëpunëtorët të cilët punon.
- 1.5.Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit, të cilit i raporton, dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktojë ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- 1.6.Të mos kërkojë apo të pranojë udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç DKA-së.
- 1.7.Të mos e shfrytëzoj pozitën e punës për interesa private në dobi të ndonjë pale të tretë, përfshirë edhe familjen, shoqërinë apo miqësinë e tij.
- 1.8.Të ushtrojë maturi maksimale lidhur me të gjitha çështjet e punës. Përfshirë, ruajtjen e informatave (nëse nuk janë publike), të cilat lidhën me procesin e punës dhe raporteve të krijuara prej saj, duke mos komunikuar këto informata me asnjë person fizik dhe juridik, përveç kur informatat e tilla janë të parapara në kuadër të detyrave sipas kësaj kontrate apo autorizimit nga zyrtari të cilit i raporton.
- 1.9.I punësuari sipas kësaj kontrate, nuk do të kryejë punë apo detyrë tjetër, me orar të plotë, nëse puna e tillë, bie ndesh me aktet përkatëse ligjore dhe nënligjore, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga DKA-ja ose përfaqësuesit të saj.

1.10. Puna do të monitorohet dhe të vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve, sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar, sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen. Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim. Testi me shkrim në maksimum tërheqë 100 pikë apo deri në 50% të vlerësimit përfundimtar.

Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim i nënshtrohen intervistimit me gojë. Në intervistën me gojë kandidatët mund të vlerësohen në maksimum deri 100 pikë apo 50% e vlerësimit përfundimtar.

Vlerësimi në intervistimin me gojë bazohet në këto kriterë:

Njohuritë e përgjithshme - 25 pikë,  
Aftësitë e përgjithshme dhe të personalitetit - 35 pikë, dhe  
Njohuritë profesionale - 40 pikë (ku përfshihen përvoja e punës dhe kualifikimi profesional gjatë studimeve). Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidati me më shumë pikë do të përzgjidhet në pozitën e lartcekur.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata të cilat janë të dëshmuara me dokumente dhe jo ato që janë të deklaruara pa dëshmi. Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës, diplomat duhet t'i kenë të nostifikuara nga MASH-i.

Për intervistë do të ftohen ata kandidatë që i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të lartcekura.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test, intervistë si dhe orari i intervistës do të publikohen në web faqen e Komunës së Fushë-Kosovës.

**<https://kk.rks-gov.net/fushekosove/>**

Me këtë konkurs zhvillohen procedurat e rekrutimit për vitin shkollor 2021/2022. Në rast të ndonjë nevojë eventuale për mësimdhënës/e në IEM, do të bëhen angazhime sipas renditjes së listës së publikuar me rastin e shpalljes së rezultateve.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

#### **Afati dhe mënyra e aplikimit:**

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e

informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më **02.08.2023** deri më **16.08.2023**.

Aplikacioni i kompletuar me të gjitha dokumentet e kërkuara duhet të dorëzohet në Komunë përmes protokollit, përkatësisht përmes Arkivit në objektin e Komunës së Fushë-Kosovës.

**Vërejtje:** Pas aplikimit kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit e cila është e domosdoshme për fazat e tjera të proceduarave të konkursit.

Adresa: Objekti i Komunës, rruga Tahir Zemaj nr.2, Fushë-Kosovë.

Drejtoria për Arsim  
Fatlum Berisha

